



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 51.1 dhe 53.1, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 4, 9 dhe 10 Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, dhe neneve 14, 45.1 dhe 47.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, në procedurën e rishqyrtimit të Vendimit sipas rekomandimeve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me shkresën nr.02-310/5 të datës 08.03.2018, mori:

VENDIM

PËR THEMELIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

- | | |
|---------------------------------------|----------------------------------|
| 1. Valbona Kadriu - Podvorica, | anëtare nga radhët e LDK-së |
| 2. Benjamin Ejupi, | anëtar nga radhët e PD-së |
| 3. Doruntina Hasani, | anëtare nga radhët e LVV-së |
| 4. Bashkim Sylja, | anëtar nga radhët e PDK-së |
| 5. Shaban Ahmeti, | anëtar nga komuniteti Ashkalinj |
| 6. Valmira Lahu, | anëtare nga komuniteti Ashkalinj |
| 7. Albina Avdiu, | anëtare nga komuniteti Ashkalinj |
| 8. Mefail Rama, | anëtar nga komuniteti Rom |
| 9. Radisav Perović, | anëtar nga komuniteti Serb |

Neni 2

Mandati i anëtarëve të Komitetit sipas nenit 1 të këtij vendimi, ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të mandatit të Kuvendit të Komunës, ndërsa ndryshimi dhe plotësimi eventual, bëhet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 3

Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurat e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunë, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës së Kuvendit, dhe dispozitat tjera përkatëse në fuqi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës

Nr. 01-020/04-0026817/18

Podujevë,

28 mars 2018



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi